



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 336/3 prot.,

Tiranë, më 29.01.2019

VENDIM
Nr. 10, datë 29.01.2019

PËR

**MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS SË BORDIT TË ADMINISTRIMIT TË
UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË, PËR PERIUdhËN JANAR – MARS 2019**

Në bazë të Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, pas shqyrtimit të propozimit të Administratorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, Nr. 2814 prot., datë 03.12.2018 “Propozim për projekt-programin e mbledhjeve”, dhe pas diskutimeve në mbledhjen e datës 07.01.2019 dhe mbledhjes së datës 29.01.2019, Bordi i Administrimit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë,

VENDOSI:

1. Të miratojë miratojë planin e punës së Bordit të Administrimit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë për periudhën Janar – Mars 2019.
2. Plani i punës do të jetë sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur dhe është pjesë integrale e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Adriana BERBERI

Adriana Berberi



Lidhja nr. 1:

Plani i punës për Bordin e Administrimit për periudhën Janar – Mars 2019

Për muajin Janar:

1. Miratimin e detajimit të graniti të mësimdhënies të dërguar nga MARS.
2. Miratimi i planit të mbledhjeve të Bordit të Administrimit për periudhën janar -Mars.
3. Miratimi i planit vjetor të punës së Njesisë së Auditimit të Brëndëshëm.
4. Analiza e realizimit të planit vjetor të punës së Njesisë së Auditimit të Brendshëm.
5. Miratimi i listave të studentëve përfitues të bursave sipas vendimeve të Keshillit të Ministrave.
6. Miratimi i stukturës së UMT-së.
7. Takim me drejtuesit e Këshillave studentore të fakulteteve për problematikat që lidhen me project-buxhetin 2019.

Për muajin Shkurt:

1. Takim i përbashkët me rektoratin për diskutimin e problematikave që lidhen me përgjësitetë respective në funksion të koordinimit dhe bashkërendimit më të mirë.
2. Raportim nga Administratori mbi realizimin e pritshëm të Buxhetit të vitit 2018.
3. Miratimi i detajimit të buxhetit të UMT-së për vitin 2019.
4. Raportim nga Njësia e Auditimit të Brendshëm për detyrat e muajit Janar.
5. Raport mbi përputhshmërinë e kriterëve të personave aktualisht të punësuar me kriteret e miratuara të strukture.

Për muajin Mars:

1. Diskutim i programeve të reja të propozuara nga fakultetet.
2. Diskutim i rregullores/procedurave të përzgjedhjes së projekteve të punës kërkimore-shkencore të cilat financohen nga fondet e UMT-së.
3. Raportim nga Njësia e Auditimit të Brendshëm për detyrat e muajit shkurt.
4. Miratimi i raportit vjetor të veprimtarisë ekonomike të UMT-së për vitin 2018.